



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
BERAT

Nr. 363/1 Prot.

Berat, më datë 30.11.2023

SHPALLJE

PËR LËVIZJEN PARALELE , NGRITJEN NË DETYRË DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË POZICIONIN SHEF SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, STATISTIKAVE DHE MARRDHËNIEVE ME PUBLIKUN , MEDIAN DHE ME JASHTË.

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56/7, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit nr.622, datë 10.12.2020, “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat shpall procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë e ulet drejtuese , për pozicionin

1 (një) pozicion – **SHEF SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT STATISTIKAVE DHE MARRDHËNIEVE ME PUBLIKUN , MEDIAN DHE ME JASHTË** kategoria e pagës III-2

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë drejtuese

Për të tre procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë drejtuese) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

LËVIZJE PARALELE:

Afati për dorëzimin e dokumenteve **13.12.2023**

PROCEDURA E NGRITJES NË DETYRË.

Afati për dorëzimin e dokumenteve **20.12.2023**

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR:

Afati për dorëzimin e dokumenteve **27.12.2023**

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin : **SHEF SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT-STATISTIKAVE DHE MARRDHËNIEVE ME PUBLIKUN , MEDIAN DHE ME JASHTË**

- a) Menaxhon punën e sektorit;
- b) Koordinon dhe ndan detyrat në sektor;
- c) Menaxhon punën për mirëmbajtjen dhe administrimin e bazës së të dhënave në gjykatë, të mbajtura në formë elektronike nëpërmjet sistemeve kompjuterike, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;
- ç) Menaxhon punën ruajtjen e rregullt të statistikave të gjykatës;
- d) Kontrollon shkallën e zbatimit të parimeve të cilësisëstatistikore, si dhe harton raporte të veçanta dhe periodike të cilësisë për çdo tregues dhe/ose aktivitet statistikor të parashikuar;
- dh) Mbikëqyr grumbullimin, përpunimin dhe mbajtjen e të dhënave statistikore dhe për metodikën dhe mënyrën e mbajtjes së statistikës gjyqësore;
- e) mirëmbajtjen dhe kontrollin e sistemit kompjuterik, elektronik, të teknologjisë së informacionit, si dhe për ruajtjen dhe përpunimin e statistikave të gjykatës;
- ë) Ndhmon kancelarin në procesin e rekrutimit të punonjësve të tjerë të gjykatës sipas ligjit, duke përgatitur të gjitha dokumentet dhe aktet e nevojshme për këtë qëllim;
- f) Merr masa për riparimin dhe shërbimet e nevojshme për mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit.
- g) Kontrollon përdorimin me korrektësi të pajisjeve të teknologjisë së informacionit.
- gj) Kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- h) Kujdeset që shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë;
- i) Shërbimi i marrëdhënieve me publikun ndërvepron dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor mbi ecurinë e marrëdhënieve me publikun pranë gjykatave dhe kërkon mendimin e tij kur është e nevojshme;
- j) Ruajtjen e rregullt të statistikave të gjykatës.
- k) Shërbimi i marrëdhënieve me publikun ndërvepron dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor mbi ecurinë e marrëdhënieve me publikun pranë gjykatave dhe kërkon mendimin e tij kur është e nevojshme;
- l) Shërbimet e marrëdhënieve me publikun ushtrohen nga ose nën mbikëqyrjen e gjyqtarit të caktuar për marrëdhëniet me publikun;
- m) Kryen detyra të tjera, sipas urdhrave apo porosive të kryetarit, kancelarit apo Këshillit të Gjykatës.

I..LËVIZJA PARALELE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civil gjyqësor të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat

I.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA.

-Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizje paralele si vijon:

- a. Të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar., brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon(dokumenta nga institucioni)
- b. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi(dokument nga institucioni).
- c. Të ketë të Paktën vlerësimin e fundit”mirë”.

-Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon

Arsimi: Diplomë e nivelit “Master Shkencor” në Shkenca të Teknologjisë së Informacionit ose Juridike ose të barasvlerëshme me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit arsimit të lartë.

Përvoja: Të ketë kryer të paktën 3 vjet praktikë profesionale

Aftësi të tjera: Të zotërojë gjuhë të huaj - preferencë për gjuhët e BE-së;

Njohuri shumë të mira të organizimit gjyqësor dhe aktivitetit të gjykatave. Aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve; aftësi për të shkëmbyer ide, mendime për të argumentuar propozimet përkatëse; aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.

I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dokumentat si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip të publikuar në faqen zyrtare të gjykatës <https://www.gjykata.gov.al/media/4011/cv-jeteshkrimi.doc>
- b. Deklaratë mbi të dhënat e kontaktit elektronik dhe telefonik në përputhje me dokumentin tip të publikuar në faqen zyrtare të gjykatës <https://www.gjykata.gov.al/media/4012/deklarate-per-te-dhenat-e-kontaktit-te-kandidatit-2.doc>
- c. Fotokopje të noterizuar të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njësisimi nga MAS);
 - a. Fotokopje të noterizuar librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - b. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - c. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore sipas formularit tip të publikuar në faqen zyrtare të gjykatës https://www.gjykata.gov.al/media/4010/formulari-i-vetdeklarimit_gjendja-gjyqesore.pdf
- h. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

- i. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë në adresën e vendndodhjes së gjykatës:
Lagjia ‘Iliria’, Rruga “Antipatrea”, Berat nëpërmjet shërbimit postar brenda dates **13.12.2023.**

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

I.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të KLGJ www.klgj.al dhe të Gjykatës, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

I.4. FUSHA E NJOHURIVE, AFTESITE DHE CILESITE MBI TE CILAT DO TE ZHVILLOHET INTERVISTA

- a) Kodi i Procedurës Civile/Penale;
- b) Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”;
- c) Ligji nr.152/2013 “ Për nëpunësit civil”, i ndryshuar;
- d) Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat etike në administratën publike”;
- e) Ligji nr.119/2014 “Per te drejten e Informimit”
- f) . Ligji nr 49/2012 ”Për gjykatat administrative dhe gjykimin e Mosmarrëveshjeve g) Administrative”
- h) Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 i ndryshuar me ligjin Nr 48/2012 “ Për mbledhjen e të dhënave personale”
- i) Ligji nr 9880 datë 25.02.2008 “ Për nënshkrimin elektronik “
- j) Ligji nr.10325 datë 23.09.2010 “ Për bazën e të dhënave shtetërore”
- k) Ligji nr 9918 datë 19.05.2008 “ Për komunikimin elektronik në Republikën e Shqipërisë”

I.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi profesional për kandidatët fitues të fazës së parë do të kryhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur prej tyre dhe intervistes, nga Këshilli i Gjykatës sipas një sistemi pikëzimi. Kandidatët do të vlerësohen:

- a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë. Në rast rezultatesh të njëjta, Këshilli krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me vlerësimin më të lartë të punës;

- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

I.6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të KLGJ ëëë.klgj.al dhe të Gjykatës.

II. KONKURIMI NËPËRMJET PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË.

(Në rast se pozicioni i lirë i shpallur, në përfundim të lëvizjes paralele, nuk është plotësuar, pra rezulton i lirë, atëherë është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunës civil gjyqësor të një kategorie paraardhëse, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë si vijon:

- a. Të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar., brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon(dokumenta nga institucioni)
- b. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi(dokument nga institucioni).
- c. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit”mirë”.
- d. Të plotësojnë kushtet e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurim.

-Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon

1. Arsimi: Diplomë e nivelit “Master Shkencor” në Shkenca të Teknologjisë së Informacionit ose Juridike ose të barasvlershme me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit arsimin të lartë.
2. Përvoja: Të ketë kryer të paktën 3 vjet praktikë profesionale
3. Aftësi të tjera: Të zotërojë gjuhë të huaj - preferencë për gjuhët e BE-së; Njohuri shumë të mira të organizimit gjyqësor dhe aktivitetit të gjykatave. Aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve; aftësi për të shkëmbyer ide, mendime për të argumentuar propozimet përkatëse; aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.

II.2 I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës se Shkallës së Parë te Juridiksionit te Përgjithshëm Berat, dokumentet si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip të publikuar në faqen zyrtare të gjykatës <https://www.gjykata.gov.al/media/4011/cv-jeteshkrimi.doc>
- b. Deklaratë mbi të dhënat e kontaktit elektronik dhe telefonik në përputhje me dokumentin tip të publikuar në faqen zyrtare të gjykatës <https://www.gjykata.gov.al/media/4012/deklarate-per-te-dhenat-e-kontaktit-te-kandidatit-2.doc>
- c. Fotokopje të noterizuar të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- d. Fotokopje të noterizuar librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore sipas formularit tip të publikuar në faqen zyrtare të gjykatës https://www.gjykata.gov.al/media/4010/formulari-i-vetdeklarimit_gjendja-gjyqesore.pdf
- h. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- k. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- l. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë në adresën e vendndodhjes së gjykatës: Lagjia “Iliria”, Rruga “Antipatrea”, Berat, nëpërmjet shërbimit postar brenda dates **20.12.2023**. Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit. Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

I.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të KLGJ www.klgj.al dhe të Gjykatës, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

I.4. FUSHA E NJOHURIVE, AFTESITE DHE CILESITE MBI TE CILAT DO TE ZHVILLOHET INTERVISTA

- a. Kodi i Procedurës Civile/Penale;
- b. Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”;
- c. Ligji nr.152/2013 “ Për nëpunësit civil”, i ndryshuar;
- d. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat etike në administratën publike”;
- e. Ligji nr.119/2014 “Per te drejten e Informimit”
- ë. Ligji nr 49/2012 ”Për gjykatat administrative dhe gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”

- h) Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 i ndryshuar me ligjin Nr 48/2012 “ Për mbledhjen e të dhënave personale”
- i) Ligji nr 9880 datë 25.02.2008 “ Për nënshkrimin elektronik “
- j) Ligji nr.10325 datë 23.09.2010 “ Për bazën e të dhënave shtetërore”
- k) Ligji nr 9918 datë 19.05.2008 “ Për komunikimin elektronik në Republikën e Shqipërisë”

II.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- a.70 (shtatëdhjetë) pikë për vlerësimin e dokumentacioni e dorëzuar, që konsiston në vlerësimin e rezultateve të punës , përvojës profesionale dhe trajnimeve të lidhura me fushën përkatëse
- b.30 (tridhjetë) pikë për intervistën e strukturuar me gojë

I.6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të KLGJ www.klgj.al dhe të Gjykatës.

III.PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është I vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës .

II.1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA

Sipas nenit 55 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor janë:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

f. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shtuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

1. Arsimi: Diplomë e nivelit “Master Shkencor” në Shkenca të Teknologjisë së Informacionit ose Juridike ose të barasvlershme me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit arsimor të lartë
2. Përvoja: Të ketë kryer të paktën 3 vjet praktikë profesionale
3. Aftësi të tjera: Të zotërojë gjuhë të huaj - preferencë për gjuhët e BE-së;

Njohuri shumë të mira të organizimit gjyqësor dhe aktivitetit të gjykatave. Aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve; aftësi për të shkëmbyer ide, mendime për të argumentuar propozimet përkatëse; aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.

II.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- a. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip të publikuar në faqen zyrtare të gjykatës <https://www.gjykata.gov.al/media/4011/cv-jeteshkrimi.doc>
- b. Deklaratë mbi të dhënat e kontaktit elektronik dhe telefonik në përputhje me dokumentin tip të publikuar në faqen zyrtare të gjykatës <https://www.gjykata.gov.al/media/4012/deklarate-per-te-dhenat-e-kontaktit-te-kandidatit-2.doc>
- c. Fotokopje të noterizuar të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- g. Fotokopje të noterizuar librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- h. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- i. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore sipas formularit tip të publikuar në faqen zyrtare të gjykatës https://www.gjykata.gov.al/media/4010/formulari-i-vetdeklarimit_gjendja-gjyqesore.pdf
- h. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- m. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- n. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

-Dokumentet duhet të dorëzohen me postë në adresën e vendndodhjes së gjykatës: : Lagjia Iliria , Rruga Antipatrea , Berat nëpërmjet shërbimit postar brenda dates **27.12.2023.**

II.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

KLJGJ do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe të çdo Gjykatës listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i gjykatës individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e mospajtimin. Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendrike ngadana e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendrike nga data e depozitimit të saj.

II.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- Kodi i Procedurës Civile;
- Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”;
- Ligji nr.152/2013 “ Për nëpunësit civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat etike në administratën publike”;
- Ligji nr.119/2014 “Per te drejten e Informimit”
- Ligji nr 49/2012 ”Për gjykatat administrative dhe gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”
- Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 i ndryshuar me ligjin Nr 48/2012 “ Për mbledhjen e të dhënave personale”
- Ligji nr 9880 datë 25.02.2008 “ Për nënshkrimin elektronik “
- Ligji nr.10325 datë 23.09.2010 “ Për bazën e të dhënave shtetërore”
- Ligji nr 9918 datë 19.05.2008 “ Për komunikimin elektronik në Republikën e Shqipërisë”

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

II.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.
- b. 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli. Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLGJ do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe nëfaqen e Gjykatës. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet. Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor përkategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e KLGJ dhe të Gjykatës, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:
 - Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.
 - Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor www.klgj.al dhe të Gjykatës.

Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat

ANËTAR
EUGEN SYLARI

ANËTAR
KLEJDA MEÇI

KRYETAR
PELLUMB ZAIMI

V.O.:Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.85, datë 11.03.2021 "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor" të Këshillit të Lartë Gjyqësor publikuar në faqen zyrtare të tij www.klgj.al